

MESAZHI

I GJON PALIT TË DYTË ME RASTIN E DITËS SË 25 BOTËRORE TË PAQËS

Besimtarët e bashkuar për ndërtimin e paqës

1 Më 1 janarin e ardhshëm, si zakonisht, do të celebrohet Dita e Përvitshme Botërore e paqes. Do të mbushen 25 vjet nga dita kur u celebraua për herë të parë, dhe është krejt e natyrshme që në këtë përvjetor mendimet e mia të drejtohen me një mirënjohje e admirim të pandryshueshëm kah figura e dashur e paraardhësit tim të ndritshëm Pavlit të 6, I cili me një intuitë të lumnueshme pastorale e pedagogjike deshi t’I ftonte të gjithë “ miqtë e vertetë të paqes” në bashkim për të reflektuar për këtë “ të mirë të parë” të njerëzve. Por është po aq e natyrshme, në distancën e një çerek shekulli, të vështrojmë të kaluarën në tërësinë e saj për të verifikuar nëse më të vertetë çështja e paqes në botë ka bërë ndopak progres, dhe në qoftë se ngjarjet e muajve të fundit - disa prej të cilave janë në vazhdim, për fat të keq kanë shënuar një prapambetje esenciale, duke treguar sa real është rreziku që arsyeja njerëzore po len të dominojë egoizmi destruktiv ose urrejtja që ka lëshuar rrënjë thellë. Në të njëjtën kohë, progresi i demokracive të reja u ka dhënë shpresë popujve të tërë duke zgjuar besim për një dialog të fuqishëm nderkombëtar dhe duke hapur prepaktiva për një proces fatlum paqeje. Në një kuptim të tillë dritë e hije këtë vit mesazhi nuk është as një bilanc as një proces, por një grishje e re vëllazërore për të reflektuar mbi ngjarjet njerëzore të momentit, për t’I ngritë ato në një vizion etiko-fetar, nga I cili besimtarët duhet të frymëzohen

Pikërisht në arsyen e fesë së tyre, ata janë të grishur-individualisht e të gjithë së bashku-për të qenë mesazherë e ndërtues të paqes si të tjerët e më tepër se të tjerët ata janë të grishur për të rikërkuar me butësi dhe ngulm përgjigjet e përshtatshme për shpresat e sigurisë e të lirisë, të solidaritetit e të mbështetjes në këtë botë, që si të thuash është bërë më e vogël, e ku njerëzit jetojnë në shoqëri. Sigurisht, angazhimi në favor të paqes përfshin çdo person vullnetmirë, dhe është ky motivi për të cilin Mesazhet e ndryshme u janë adresuar të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore. Megjithatë, detyra imponohet me urgjencë profecisë së fesë së Zotit dhe për më tepër të krishterëve, që kanë si udhërrëfyes e mësues “Parimet e paqes” (Is 9,5).

2 Natyra morale e fetare e paqes.

Aspirata për paqe është e ngulitur thellë në natyrën njerëzore e gjendet në fe të ndryshme. Ajo shprehet në dëshirën për rregull e qetësi, në qëndrimin ndaj të tjerëve, në bashkëpunimin e bashkëpjesmarrjen të bazuara në respektin reciprok. Vlera të tilla të sugjeruara nga ligji natyral e të ripropozuara nga feja, kërkojnë të zhvillohet ndihmesa e të gjithëve: e njerëzve të politikës, të drejtuesve të organizatave nderkombëtare, të sipërmarrësve e të punëtorëve, të grupeve joshoqërore e të qytetarëve privat. Është fjala për një detyrë preçize për të gjithë që I ngarkon më tepër me detyrime në qoftë se janë besimtarë: Të dëshirojmë paqen, të veprojmë e të lutemi për të e gjithnjë në përputhje koherente me fenë. Kjo shpjegon faktin që në librat e shejtë të feve të ndryshme referimi që I bëjmë paqes zë një vend të rëndësishëm në kuadrin e jetës njerëzore në vetë raportet e njerëzve me Zotin. Kështu, p.sh., në qoftë se për ne të krishterët Jezu Krishti, Biri I atij që ka “plane për paqe e jo për fatkeqësi” (Ger 29,11), është “paqa jonë” (Ef 2,14), përvëllezërit hebrej fjala “shaloni” shpreh urim e bekim në gjendjes e saj të lumturisë të njeriut me vetvetën, me natyrën e me Zotin, ndërsa për besimtarët muslimanë termi “selam” është shumë I rëndësishëm për të zëvendësuar një prej emrave hyjnor të mrekullueshëm. Mund të thuhet që një jetë fetare, në qoftë se është jetuar me të vertetë nuk ka se si të mos prodhojë frute paqeje e vëllazërimi, sepse është në natyrën e fesë të nxisë një rrugë gjithnjë e më të ngushtë me hyun e të favorizojë një marrëdhënje gjithnjë e më solidare mes njerëzve.

3 Të ringjallim “shpirtin e Asizit”

I bindur për këtë konvergim rreth vlerave të tilla, pesë vjet më parë m’u drejtuan përgjegjësit e kishave katolike dhe të feve të mëdha të botës për t’I ftuar në një prej takimeve speciale të lutjes për paqe që

u celebrua në Asizi. Kujtimi I kësaj ngjarje të shënuar më ka sugjeruar të rimarr e të ripropozoj temën e solidaritetit të besimtarëve për të njëjtën kauzë. Në Asizi gjenden së bashku, duke ardhur nga kontinente të ndryshme, kryetarët shpirtëror të feve të ndryshme: është kjo, një dëshmi konkrete rreth dimensioneve universale të paqes, me pohimin se ajo nuk është vetëm rezultat I bisedimeve politiko-diplomatike apo të kompromiseve për interesa ekonomike, por varet në mënyrë themelore nga Ai që njih zemrën e njerëzve dhe orienton dhe drejton hapat e tyre. Si persona të preokupuar për fatet e njerëzimit, së bashku të agjerojmë, duke dashur kështu të shprehim mirëkuptimin tonë e solidaritetin ndaj miliona e miliona njerëzve, që janë viktima të urisë në të gjithë botën. Si besimtarë që kanë në zemër ngjarjet e historisë njerzore, së bashku, të shtegtojmë, duke meditaruar në qetësi për origjinën tonë të përbashkët, për kufijtë e përgjegjësive tona, për lutjet dhe shpresat e shumë vëllezërve e motrave që po presin ndihmën tonë për nevojat e tyre.

Atë që kemi bërë duke u lutur e duke treguar angazhimin tonë të fortë për paqen mbi tokë, duhet të vazhdojmë e ta bëjmë edhe sot.

Duhet ta mbajmë gjallë “shpirtin e pastër të Asizit”, jo vetëm për një detyrë keherente të besimit, por edhe për të ofruar një motiv shprese brezave të ardhshëm. Në qytetin e të Varfërit kemi nisur një marrshim të përbashkët që duhet të vazhdojë, pa përjashtuar sigurisht kërkimet e rrugëve të tjera e mjeteve të reja për një paqe të fortë e ndërtuar mbi themele shpirtërore.

4 Forca e lutjes

Para se t’u drejtohem burimeve njerzore, dua të pohoj nevojën e një lutje intensive e të përvujtë, me besim e ngulm, në qoftë se duam që bota të bëhet përfundimisht shtëpia jonë e paqes: lutja është mjete më I përsosur për t’u përgjenuar e për të mbajtur gjallë paqen. Ajo (lutja) ngjall guxim dhe I jep mbështetje cilitdo që don dhe nxit të mira të tilla sipas mundësive të veta e në ambiente të ndryshme në të cilat ndodhet. Ajo, ndërkaq I hap rrugë takimit me Hyninë, përgatit edhe takimin më të afërmin tonë, duke e ndihmuar për të vendosur mbarëvajtjen tonë me të gjithë pa asnjë diskriminim, raporte respekti, mirëkuptim, nderim e dashuri.

Ndjenja fetare dhe shpirti I sjejtë jo vetën bëjnë të rritet jeta jonë e brenshme, por na ndriçojnë edhe rreth domethënies së vertetë të prezences sonë në botë. Mund të thuhet edhe që dimensionin fetar na shtyn t’I japim më angazhim të madh kontributit tonë për ndërtimin e një shoqërie ku sundon rregulli, ku mbretëron paqa. Lutja është rruga që më shumë efekt na bashkon: me hirin e saj besimtarët takohen përtej pabarazisë, mosmarrveshjeve, inatit e armiqësisë që janë tejkaluar, domethënë jemi para Perëndisë, para Zotit, babait të të gjithëve. Ajo në shprehjen e vet të vertetë të raporteve të drejta me Zotin e të tjerët, tashmë është një ndihmes pozitive për paqe.

5 Dialogu ekumenik dhe marrëdhënjet ndërfitare.

Lutja nuk mund të mbetet vetme dhe ka nevojë të shoqërohet me veprime të tjera konkrete. Cdo fe ka një vizion rreth akteve që duhet të përmbushë e rrugët që duhet të ndjekë për të arritur paqen. Kisha katolike, ndërkaq e shpall qartë identitetin e saj, doktrinën dhe misionin e saj shpëtimtare për të gjithë njerëzimin, “nuk kundërshton asgjë që është e vertetë dhe e shejtë” në fetë e tjera, ajo ka konsideratë dhe respekton sinqerisht ato metoda të vepruari e të jetuari. Këto rregulla e doktrina që megjithëse në shumë pika ndryshojnë nga ajo që është ajo vetë beson e propozon, megjithatë jo rrallë reflektohet një rreze nga e asaj të vertetë që ndriçon gjithë njerzimin”.(Dichiar. Nostra Aetate, 2)

Pa shpërfill dhe as zvogëluar ndryshimet, Kisha është e bindur që në procesin e nxitjes së paqës, janë disa elemente ose aspekte që mund të zhvillohen ose të realizohen së bashku me ithtarët e feve e besimeve të tjera. Në këtë mënyrë kemi kontaktet ndërfitare dhe, në një mënyrë krejt të veçantë, dialogun ikumenik. Në saj të formave të tilla të ballafaqimit e të shkëmbimit, fetë kanë mundur të arrijnë një ndërgjegje më të qartë për përgjegjësitë e tyre, që nuk janë të lehta, në raport me të mirat e verteta të të gjithë njerzimit.

Sot fetë duken shumë të vendosura për të mos u instrumentalizuar për interesa të veçanta apo qëllime politike e përpiqen të marrin një qëndrim më të ndërgjegjshëm e më të prerë për ngjalljen e realitetit

social e kulturor në komunitetin e popujve. Kjo u siguron atyre të jenë një forcë aktive në procesin e zhvilluar e të ofrojë kështu një shpresë të sigurtë për njerzimin.

Në rrethana jo të pakta duket qartë që veprimi I tyre do të ishte më efikas po të ishte në bashkëpunim e I koordinuar.

Një procedurë e tillë e besimtarëve mund të jetë __predikuese__ për paqësimin e popujve e shmangien e dasive të pranishme edhe sot mes “zonave” e “botëve”

Rruga që kemi për të bërë

6 Për të arritur këtë qëllim të një bashkëpunimi për çështjen e paqes mbetet ende shumë rrugë: është rruga e ndihmës reciproke, që sor favorizohet nga zhvillimi I mjeteve të komunikimit shoqëror e lehtësuar nga nisja e një dialogu të gjerë e besnik; është rruga e ndjenjes bujare, pajtimit vëllazëror, I bashkëpunimit edhe në sektorët e ngushtë ose sekondar, por gjithmonë në shërbim të vetë çështjes, është rruga, më në fund, e bashkëjetesës së përditshme në ndarjen e përpjekjeve dhe sakrificave për të arritur të njëjtin qëllim.

Në këtë rrugë ndoshta u takon besimtarëve të veçantë, domethënë personave që ushtrojnë një fe ende përpara udhëtimit të tyre, të marrin në sy mundimet, e në të njëjtën kohë, të kenë kënaqësinë të ndërtojnë së bashku paqëri. Kontaktet ndërjetare, përkrah dialogut ilumenik duken tashmë rrugë të detyrueshme, sepse shumë mundime të dhimshme, të përjetuara në rrugën e gjatë të shekujve, nuk ngjasin më e disa mbeturina po shërohen shpejt.

Kush beson duhet të jetë ditat I paqes, krijuesi I saj para së gjithash, me shembullin personal, me sjelljen e vet të drejtë që I buron së brendshmi, dhe që projektohet jashtë shpirtit të tij në veprime e sjellje koherente: kthjelltësia, ekuilibri, mposhtja e instikteve të shprehë vullnetin e mirëkuptimit, të ndjenjës, të faljes bujare; të gjitha këto ushtrojnë një fluks paqeje mes personave të të njëjtit ambient e komunitet fetar e qytetar.

Pikërisht për këtë, në Ditën e ardhshme, unë ftoj të gjithë besimtarët të përmbushin një seri ushtrimesh të ndërgjegjes, për të qenë më tepër të gatshëm që të ndigjojnë zërin e “Zotit të paqes” (Cfr 1 Cor 14,33) dhe për t’ju dedikuar me një besim të ri ndërmarrjes së madhe.

Jam më të vertetë I bindur që ata - dhe uroj që edhe njerëzit vullnetmirë- do ta pranojnë apelin tim të ri, këmbëngulja me të cilin unë e paraqes, kushtëzohet nga gjendja e rëndë e momentit.

Të ndërtojme së bashku paqen të bazuar në drejtësi.

7 Lutja dhe veprimi I njëkohshëm I besimtarëve ne favor të paqes duhet të ballafaqohen me problemet dhe aspiratat e ligjshme të personave e të popujve. Paqa është një e mirë themelore që mbart respektin dhe nxitjen e vlerave esenciale të njeriut: të drejtën për jetë në të gjitha fazat e zhvillimit; të drejtën e të gjitha konsideratave pavarësisht nga raca, seksi apo bindje fetare; të drejtën për të pasur të mirat e nevojshme materiale për jetesë, të drejtën për punë e për një bashkëjetesë të rregullt e solidare. Si njerëz, si besimtarë e për më tepër si të krishterë duhet të ndjehemi të angazhuar të jetojmë këto vlera të drejtësisë, që gjejnë kurorëzimin e tyre në rregullin suprem të mëshirës:

“Duaje të afërmin tënd si veten” (Mt 22,39). Edhe një herë dua të kujtoj që respekti rigoroz I lirisë së fesë e të drejtës përkatëse është pohimi bazë I bashkëjetesës paqësore. Uroj që ai të jetë një angazhim jo vetëm I pranuar, por realisht I aktualizuar nga Kryetarët politik e fetar, e nga vetë besimtarët; është kjo baza e njohjes nga e cila merr rëndësi dimensionin traushendent I njeriut. Do të ishte lajthitje sikur fetë ose grupet që I ndjekin me interpretimin praktik të feve respektive lejojnë të shfaqen forma të fundamentalimit ose të fanatizmit duke justifikuar me motive fetare luftrat dhe konfliktet më të tjerët. Në qoftë se ka një luftë të denjë për njeriun, është ajo kundër pasioneve të tij të ç’ekuilibruar, kundër çdo lloj egoizmi, kundër përpjekjeve për të përfutuar në dëm të tjetrit, kundër çdo tipi të urrejtjes e të dhunës: me një fjalë, kundër çdo gjëje që është ekzakt kundër paqes e kundër pajtimit.

Mbështetja e nevojshme nga ana e përfaqësuesve të Kombeve

8 Ju bëj thirrje, në fund, përfaqësuesve të Kombeve dhe të Komunitetit ndërkombëtar të tregojmë gjithmonë respektin më të madh për ndërgjegjen fetare të çdo njeriu dhe për kontributin e kualifikuar

në progresin e qytetërimit dhe zhvillimin e popujve. Ata nuk duhet të shkasin në tentativë për t'u shërbyer disa feve duke instrumentalizuar këtë mjet për pushtetin e tyre, sidomos kur është fjala për t'ju kundërvënë ushtarakisht kundërshtarit. Të njëjtat Autoritete civile e politike duhet t'ju sigurojnë feve respekt e garanci juridike – në nivel kombëtar e ndërkombëtar – duke evituar që kontributi i tyre në ndërlikimin e paqes të mos lihet në harresë, ose të mbyllet në sfera private, apo të injorohet drejtë për së drejti. Ju bëj thirrje sërisht autoriteteve publike të punojnë me përgjegjësi e vigjilencë për të parandaluar luftën dhe konfliktet, që të triumfojë e drejta e drejtësia, e të favorizohet në të njëjtën kohë një zhvillim për të mirën e të gjithëve, në radhë të parë, të atyre që janë shtërnguar nga zingjirët e varfërisë, nga uria dhe vuajtjet. Meritojmë të vlerësohet progresi që tashmë është bërë me reduktimin e armëve: rezervat ekonomike dhe financiare, të përdorura deri tani për prodhimin dhe tregtimin e shumë instrumentave të vdekjës, mund të perdoren në favor të njeriut e jo kundër njeriu. Jam i sigurtë se me këtë gjykim pozitiv bashkohen miliona burra dhe gra të të gjithë botës, që nuk kanë mundësi të bëjnë të dëgjohet zëri i tyre.

Një fjalë të veçantë për të krishterët

9 Në këtë pikë nuk mund të lë pa bërë një ftesë të veçantë drejtuar të gjithë të krishterëve. Feja e përbashkët në Krishtin Zot na bën të dëshmojmë me një zë “Ungjillin e paqes” (Ef 6,15). Na takon ne, në radhë të parë t'ju hapemi besimtarëvetë tjerë për të marrë përsipër së bashku me to, me guxim e ngulm, veprën e madhe të ndërtimit të asaj paqe që bota e dëshiron. “Ju lë paqen, ju jap paqen time” na ka thënë Jezuesi (Gv 14,27). Një premtim i tillë hyjnor na ngjall shpresa bile sigurinë e shpresës sonë hyjnore që paqa është e mundur, sepse asgjë nuk është e pamundur me besimin në Zotin (8Cfr Lc 1,37). Paqa e vertetë në fakt, është gjithmonë një dhuratë e Zotit, dhe për ne të krishterët është dhuratë e çmuar e Krishit të Ringjallur (Cfr Gv 20,19,26).- në sfidat e mëdha të botës bashkohore, shumë të dashur Vellezër e Motra të Kishës katolike, lipset t'u përgjigjemi duke bashkuar forcat me të gjithë ata që ndajnë me ne disa vlera të thella, duke filluar nga ata të sferës fetare e morale. E ndër këto sfida na duhet të përballojmë gjithnjë atë të paqes. Të ndërtojmë së bashku me besimtarët e tjerë e atëherë kemi jetuar në shpirtin e bekuar të ungjillit. “Qofshin bekuar punëtorët e paqës, sepse do të thirren bijtë e Zotit” (Mt 5,9)